

# **STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË KOLEGJIT UNIVERSITAR TBU**

**PER VITET AKADEMIKE**

**2018 - 2024**

**TIRANË, DHJETOR 2018**

## 1. Ecuria e TBU deri në përfundim të vitit akademik 2017-18

Tirana Business University College (TBU) e nisi veprimtarinë e vet në Tetor 2010 bazuar në një program fillestar, vijuar me një Strategji Zhvillimi për gjashtë vitet pasardhëse akademike 2011-2017. Strategjia u rishikua dhe u përmirësua në Nëntor 2014 bazuar në rezultatet e arritura deri në atë moment si dhe në kushtet e momentit dhe të pritshme.

Që në fillim TBU u krijua si një shkollë e lartë e profilizuar në dy fakultete/dy programe bazë – Administrim Biznesi (me profil Menaxhim, Marketing, Kontabilitet&Financë) dhe Drejtësi (profil E Drejtë Biznesi) si dhe me dy ciklet përkatëse – Bachelor dhe Master (profesional dhe i shkencave) - e me objektiv kryesor cilësinë e përgatitjes së studentëve, matur në radhë të parë, përmes shkallës së punësimit të tyre përpara diplomimit në ciklin bachelor apo ngjitjes në karrierë për studentët e ciklit master.

Duke adaptuar këto tregues të cilësisë së vet, TBU pranoi që cilësinë e saj do ta percaktonin palë të treta – punëmarrësit – pra subjekte mjaft më objektive se vetë TBU, duke shmangur kështu subjektivitetin në vetëvlerësimin e cilësisë.

Objektivi kryesor strategjik i TBU ishte **“Arritja e niveleve më të larta të cilësisë së produktit të vet - studentit me dije teorike dhe aftësi praktike - të këtilla që rrisin ndjeshëm mundësitë e tij për punësim, si rregull, para mbarimit të ciklit Bachelor ndërsa gjatë atij Master, studentit i punësuar arrin të bëjë një hap më lart në karrierë”**

Në shërbim të këtij objektivit u ndërtuan dhe u përmirësuan vit-pas-viti struktura organizative, programet dhe metodat e mësimdhënies, përfshirja e praktikave profesionale që në vitin e parë bachelor e me rritje të shkallës së angazhimit në vitet e mëtejshme të studimit, përfshirja e studentëve në punë të kontraktuara me pagesë në kompani dhe banka, përshtatja e orarit dhe kalendarit mësimor dora-dorës me rritjen dhe angazhimin në praktikë dhe punë të studentëve, përdorimi i metodave më të personalizuar e në grupe të vogla të mësimit dhe zgjerimit të hapësirës së përzgjedhjes kurrikulare, plotësimi i strukturës me staf akademik me kompetenca adekuate, veçanërisht lidhur me përvojën profesionale në punë, zgjerim të partneritetit me kompanitë, bankat dhe zyrat profesionale etj. TBU bëri gjithçka që mundi për të siguruar një proces formimi profesional si kombinim i njëkohëshëm i teorisë me praktikën sipas një spiraleje ngritëse përgjatë viteve të shkollimit.

Ndërsa të gjitha këto masa të marra janë të vetëkuptueshme në raport me objektivin parësor, vendimi më i rëndësishëm në shërbim të arritjes së objektivit ka qenë ai mbi përmasat e TBU, matur me numrin e studentëve. Sipas strategjisë, çdo vit do të pranoheshin rreth 110 studentë në ciklin bachelor dhe rreth 90 në ciklin master, me një raport rreth 4:1 mes studentëve të Fakultetit Administrim Biznesi dhe atij të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në kapacitetin e saj normal, TBU kishte llogaritur një kapacitet për 400- 500 studentë ekuivalent me kohë të plotë gjithsej (student që ndjekin studimet brenda kohës normale të programit përkatës) pa llogaritur këtu studentët që për arsye të ndryshme vijojnë studimet përtej kohës normale përkatëse por brenda afatit ligjor.

Dimensioni sasior i TBU u përcaktua që në fillim në raport me sistemin ekonomik dhe potencialin e tij punësues për profesionet që mësohen në TBU. Ky vlerësim i kujdesshëm fillestar dhe treguesit e arritjes së objektivit tregojnë se zgjedhja strategjike e bërë ishte e duhura.

TBU e filloi veprimtarinë e vet në vitin 2010 me 15 studentë në vitin e parë të ciklit bachelor dhe 28 studentë në programet Master. Regjistrimet në rritje të përvitshme bënë që në vitin akademik 2017-18, numri i studentëve ekuivalentë me kohë të plotë, gjithsej, të arrinte shifrën 430 nga të cilët 340 në Fakultetin Administrim Biznesi dhe 90 në Fakultetin e Drejtësisë.

Lidhur me objektivin kryesor, atë të cilësisë matur përmes punësimit, rezulton se nga 95 studentë të diplomuar në ciklin Bachelor, në fund të vitit akademik 2017-18, 82 prej tyre rezultuan të punësuar në profil javë e muaj përpara ditës së diplomimit ndërsa nga 55 studentë të diplomuar në ciklin master të paktën 40 prej tyre kishin ngjitur një shkallë më lart në karrierë.

Këto të dhëna merren çdo vit nga relacionet e praktikave të studentëve, pyetësorët me studentët dhe verifikime të tjera dhe janë lehtësisht të verifikueshme nga kushdo, mjafton që të vijë në TBU e të pyesë direkt studentët tanë.

Shkalla e punësimit apo e ngjitjes në karrierë ka qenë e lartë edhe në vitet pararendëse por vitin 2017-18 merr kuptim të plotë pasi numri i diplomimeve në bachelor dhe master këtë vit akademik është më i larti në historinë e shkollës dhe shumë pranë kapacitetit teorik të plotë krahasuar me vitet pararendëse. E njëjta gjë vlen edhe për ciklin master. Këtë vit akademik u diplomuan më shumë se 80% e studentëve të vitit të tretë bachelor për të dy fakultetet, duke marrë parasysh këtu që numri i studentëve të vitit të tretë ishte shumë më i lartë se një vit më parë.

Cilësia e TBU vërtetohet edhe nga vetë studentët. Shkalla e vlerësimit të studentëve të TBU për cilësinë e shërbimeve që i'u ofrohet nga shkolla është shumë e lartë. Kjo del jo vetëm nga sondazhet periodike që TBU bën me studentët e vet por edhe nga testime të të tretëve siç është rasti i pyetsorit të aplikuar nga ASCAL në vitin akademik 2016-17 në funksion të riakreditimit institucional të TBU. Nga ky pyetsor, rezultatet e të cilit na u bënë të ditura nga vetë ASCAL, rezulton se mbi 90% e studentëve dhanë vlerësime pozitive maksimale me 5 dhe 4 pikë për thujtje të gjitha pyetjet ndërsa standardi mbi përkujdesin e TBU për studentët dhe karrierën e tyre mori vlerësimin maksimal në riakreditimin institucional. Kjo shpjegon edhe faktin që studentët e TBU janë përhapësit kryesorë të opinionit pozitiv për TBU dhe faktori kryesor i tërheqjes në rritje të aplikantëve për regjistrim në programet tona.

Bazuar në këto rezultate u pa e arsyeshme që TBU mund të përballojë me sukses një rritje të mëtejshme të numrit të studentëve ekuivalent me kohë të plotë drejt numrit maksimal prej 500 studentë gjithsej. Gjithsesi ky numër nuk do të vinte përmes rritjes së numrit bruto të pranimeve në vitin e parë bachelor dhe master – kuotat do të mbeteshin thujtje konstante -por si pasojë e rritjes së cilësisë së studentëve pra, si pasojë e uljes së shkallës së humbjes së studentëve përgjatë viteve të shkollimit.

Kështu, sipas regjistrimeve të reja për vitin akademik 2018-19, dhe pas dy ç'regjistrimeve të ndërmarra në përfundim të vitit akademik 2016-17 dhe 2017-18 për studentët në tejkallim të afateve maksimale ligjore të studimeve përkatëse, numri gjithsej i studentëve ekuivalent me kohë të plotë arriti në 500 vetë nga të cilët 395 në Fakultetin Administrim Biznesi dhe 105 në Fakultetin e Drejtësisë (pa llogaritur këtu 65 studentë, 49 në master dhe 16 në bachelor, që nuk arritën të përfundojnë diplomimin brënda afatit normal përkatës por që, shumica, kanë shumë pak kredite për të marrë deri në diplomimin përkatës përgjatë vitit akademik 2018-19).

Ne jemi besimplotë që kjo rritje e numrit të studentëve në limitin maksimal të sipërm nuk do çënojë shkallën e arritjes së objektivit kryesor. Mjafton këtu të përmendim se që në fillim të vitit

akademik 2018-19, grupi i studentëve të vitit të tretë në programin Administrim Biznesi rezulton në më shumë se gjysmën e tij i punësuar në profil e deri në fund të vitit akademik do të punësohet thuajse i gjithi.

Për shkak të këtyre arritjeve dhe përhapjes së opinionit pozitiv, në rradhë të parë nga vetë studentët tanë, edhe shkalla e konkurimit për tu pranuar në TBU është rritur ndër vite.

Kështu, sipas të dhënave që nxirren lehtësisht nga sistemi elektronik i aplikimeve për shkollën e lartë, në vitin 2016-17 për 110 kuotat e pranimit në bachelor aplikuan 291 aplikantë, në vitin 2017-18 aplikuan 373 aplikantë ndërsa në regjistrimet 2018-19 aplikuan 627 aplikantë. Krahasuar me shkolla të tjera private e për të njëjtat programe, TBU rezulton me treguesin më të lartë të raportit aplikant/kuotë pranimi në ciklin Bachelor dhe me diferencë nga vendi i dytë dhe i tretë. Nderkohë që të gjitha shkollat e tjera private kanë aplikantë më pak se sa kuota. Me gjasa në vitin akademik 2019-20 do t'i afrohem raportit 10:1 aplikant:kuotë.

Gjithashtu, në vitin akademik 2018-19 për herë të parë numri i aplikantëve në programet master tejkaloi numrin e kuotave të pranimit duke bërë që konkurenca në hyrje të shfaqet për herë të parë edhe në këtë cikël.

Rritja e konkurrencës në pranim i ka dhënë mundësi TBU të rrisë cilësinë në hyrje të studentëve. Cilësia në rritje vërtetohet nga të gjithë parametrat mësimore. Kështu për vitin akademik 2017-2018 në programin bachelor Administrim Biznesi, pavarësisht rritjes së numrit të studentëve në krahasim me një vit më parë, mesatarja në nivel programi (të tre vitet) është rritur nga 7.18 në vitin 2016-2017 në 7.4 për vitin 2017-2018. Për programin bachelor në E Drejtë Biznesi, ku numri i studentëve ishte pothuaj i njëjtë me një vit më parë, mesatarja është rritur nga 7.58 në vitin 2016-2017 në 8 për vitin 2017-2018. Rritja më e ndjeshme e mesatares vihet re në vitin e parë bachelor që perkon me rritjen e madhe të konkurueshmërisë në hyrje të përmendur më lart.

Këto arritje në cilësinë në rritje të studentëve krahas rritjes së numrit gjithsej të tyre janë edhe më domethënëse përballë faktit që TBU nuk shpenzon asnjë lek për reklama televizive apo radiofonike dhe as nuk kryen marketing agresiv por vetëm informon përmes rrjeteve sociale për aktivitetet e veta dhe zhvillon çdo vit konkurse me maturantë.

Cilësia në rritje e studentëve të TBU ka ardhur edhe si pasojë e përdorimit të levës financiare përmes diferencimit të ndjeshëm të tarifave të studentëve bazuar në rezultatet mesimore individuale por edhe duke treguar pergjegjësi sociale për studentët në gjendje të vështirë ekonomike apo sociale të cilëve gjithashtu u janë ofruar zbritje të konsiderueshme e të individualizuara në tarifë, në proporcion me gjëndjen.

Një moment i rëndësishëm strategjik për TBU ishte përfshirja e Grupit Balfin si aksioner në tetor 2014. Grupi Balfin solli jo vetëm njëshesë kapitali për financimin e mëtejshëm të zhvillimit të TBU por, në radhë të parë, solli eksperiencë, know-how si dhe shumëfishim të mundësive të TBU për realizimin e praktikave studentore dhe punësimin e studentëve në kompanitë dhe partnerët e shumtë të këtij grupi.

Deri në fund të vitit akademik 2016-17 veprimtaria e TBU, për aq saç'ka qenë çdo vit diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve, është financuar nga aksionerët e saj, të cilët kanë mbuluar humbjet operative dhe nevojën për investime. Vlera kumulative e këtij financimi në fund të vitit akademik 2016-17 arriti shifrën prej afro 1 milion euro. Shkalla e humbjes operative ka ardhur

në rënie vit pas viti dhe viti akademik 2017-18 shënoi vitin më të parë kur shpenzimet vjetore të TBU, përfshirë investimet, u mbuluan tërësisht nga të ardhurat vjetore të saj.

Ndaj, bazuar në regjistrimet për vitin akademik 2018-19 dhe vlera e kontraktuar arrihet në konkluzionin se TBU ka kaluar tashmë në fazën e mundësisë për të krijuar çdo vit një surplus financiar në rritje, pjesa më e madhe e të cilit do të destinohet për zhvillim.

Momenti i rëndësishëm për TBU ka qenë edhe përshtatja e statutit dhe strukturave organizative sipas përcaktimeve detyruese të Ligjit Nr.80/2015 për arsimin e lartë, gjithashtu dhe lidhja e marrëveshjes së veçantë me Ministrinë e Arsimit sipas neneve 17/6 dhe 25/4 të këtij ligji. TBU gjithashtu kaloi me sukses riakreditimin institucional i cili evidentoi anët e forta të TBU duke lënë detyrë rritjen e angazhimit të TBU në kerkimin shkencor – detyrë kjo që po adresohet nga strategjia e re e zhvillimit dhe strategjia e veçantë për kerkimin shkencor.

TBU ka nisur në kohë përgatitjet për procesin e riakreditimit të programeve të veta duke i paraprirë mbarimit të afatit 6-vjecar të akreditimit të parë të tyre.

## **2. Proçesi i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit 2018-24**

Hartimi i strategjisë së re të zhvillimit për vitet akademike 2018-24 u bazua në përvojën e akumuluar në tetë vitet e para akademike, në analizën e kujdesshme të mjedisit ekonomik e social që na rrethon dhe në vlerësimin e drejtë të oportuniteteve dhe rreziqeve, të avantazheve dhe dobësive.

Hartimi i strategjisë nisi përmes disa tezave bazë fillestare të përpunuara nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Rektorit në mars 2017. Grupi i punës arriti në disa teza fillestare që në verën e vitit 2017 por duke konsideruar zhvillimet e pritshme deri në përfundim të vitit akademik 2016-17 si dhe ato përgjatë vitit akademik 2017-18, sugjeroi që proçesi i hartimit të strategjisë të zgjatej edhe me një vit për të përfshirë në analizë edhe zhvillimet e përvojën që do të fitohej në vitin akademik 2017-18, si një vit ku, të dhënat paraprake tregonin se kishte mjaft gjasa të pritshin disa rezultate domethënëse për përcaktimin e një strategjie të qëndrueshme shumëvjeçare. Gjithashtu u argumentua se do të ishte e dobishme për strategjinë e re edhe pritja e rekomandimeve deri në fund të proçesit të riakreditimit institucional që përfundoi në Dhjetor 2017. Sugjerimi u konsiderua i drejtë.

Grupi i punës vijoi me analizën e zhvillimeve për fundvitin akademik 2016-17 dhe zhvillimet deri në fund të vitit akademik 2017-18, duke i reflektuar këto ndryshime edhe në draftin fillestar që iu kalua Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit në Korrik të vitit 2018. Këto dy organe i gjetën të arsyeshme sygjerimet e grupit të punës dhe duke i konsideruar ato si pikënisjen e duhur ia përcollën si teza fillestare strukturave akademike, dekanateve dhe departamente, si dhe strukturave studentore dhe atyre administrative për përpunim të mëtejshëm.

Gjatë periudhës Korrik-Tetor 2018 këto struktura zhvilluan aktivitete të brendshme dhe të kryqëzuara konsultative për të arritur në formulime më të peshuara e më të zhvilluara të tezave fillestare njëherazi duke i zbërthyer ato në ide dhe plane më specifike sipas strukturave. Në

konsultime, krahas strukturave të brendshme u përfshinë edhe aktorë të jashtëm, veçanërisht kompani partnere.

Proçesi i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit u harmonizua edhe me proçesin e përgatitjes së planit buxhetor afatmesëm për vitet akademike 2018-21 si dhe me atë të hartimit të strategjisë së veçantë për kërkimin shkencor.

Strategjia e Zhvillimit mori formë të plotë në fund të Tetorit 2018 dhe u miratua filimisht nga Bordi i Administrimit e më pas nga senati Akademik në Dhjetor 2018.

### 3. Objektivat e Strategjisë së Zhvillimit 2018-24. Masat dhe metoda

Konkluzioni unanimit dhe tërësisht i konsoliduar që rezulton nga proçesi i hartimit të strategjisë për gjashtë vitet e ardhshme akademike është po ai i tetë viteve të kaluara pra që TBU duhet të vijojë të ketë si objektivin e vet numër 1 punësimin e studentëve Bachelor përpara diplomimit dhe ngjitjen në karrierë të studentëve Master përpara diplomimit si treguesi më domethënës e më objektiv i cilësisë së studentëve tanë.

Bazuar në rezultatet e arritura, objektivi Nr.1 përcaktohet edhe më qartë nga ana sasiore si vijon: **“të paktën 75% e studentëve Bachelor të jenë të punësuar në profil përpara diplomimit e po kaq të kenë ngjitur shkallë në karrierë përpara diplomimit Master”**

Natyrisht që me punësim në profil të studentëve apo ngjitje në karriere të tyre përpara diplomimit përkatës do të kuptohet në raport me kriteret e arsimimit të vendeve përkatëse të punës që shpallen nga punëdhënësit. Kuptimi i punësimit do të jetë i diferencuar edhe sipas fakulteteve dhe llojit të programit, p.sh. në rastin e studentëve të fakultetit të drejtësisë punësimi si asistent jurist brenda diplomimit në sistemin e integruar 5-vjeçar është objektiv realist pasi për punësimin apo vetëpunësimin si jurist në profesionet e lira në sferën juridike do të duhet marrja e liçencave përkatëse e kjo ndodh vetëm pas diplomimit. Në programin master i shkencave zhvillim në karrierë edhe më i suksesshëm do të konsiderohet jo vetëm karrierë profesionale në një kompani por edhe përfshirja e alumni në aktivitete akademike krahas punësimit dhe/ose në kërkim shkencor apo ndjekja prej tij e një programi të ciklit të tretë.

Për arritjen e këtij objektivi metodat kryesore që do të zbatohen janë:

- TBU do të vijojë të pranojë një numër të kufizuar studentësh njësoj si më parë – 100 deri 110 studentë në vitin e parë bachelor dhe po kaq në programet master
- do të forcohen kriteret perzgjedhëse të konkurentëve në hyrje – do të vijojnë 2 konkurset e përvitshme me maturantët, do të rritet pesha e intervistës në rezultatet e pranimit në bachelor dhe master, do të konsiderohet mundësia e rritjes së pragjeve të mesatares së notave në pranimet në bachelor dhe master, do të konsiderohet gjithashtu mundësia e përdorimit të testeve të njohurive ose e letrës së motivimit nga aplikantët në programet/ciklet e TBU. Kjo pasi pervoja na ka treguar se studentët cilësorë në mesime janë edhe më të suksesshëm në punësim.

- do të zgjerohet numri i kompanive, organizatave dhe zyrave profesionale partnere duke synuar në fund të periudhës krijimin e një rrjeti prej të paktën 120 partnerë (nga afro 60 që janë sot) të qëndrueshëm e ku do të zhvillojnë praktika apo do punësohen studentët e TBU. Natyrisht TBU do të zhvillojë partneritet me kompani të cilat kanë politika bashkëkohore në menaxhimin e burimit njerëzor dhe një mjedis stimulues e meritokrat për stafin e tyre.
- Bazuar në disa eksperiencë pozitive të ndodhura në vitin pararendës akademik, gjithashtu do të zgjerohet përfshirja e studentëve në praktika profesionale jashtë Shqipërisë përmes bashkëpunimit me agjensi të specializuara apo lidhjeve direkte të vetë TBU.
- Do të synohet rritja e shkallës së punësimit të përkohshëm me pagesë për vitin e parë e të dytë bachelor në raport me praktikën e papaguar pasi i pari rezulton me efektiv edhe në formimin profesional edhe në punësimin me kohë të plotë më të hershëm të studentit pasi pagesa forcon përgjegjshmërinë dhe disiplinën e studentit në praktikën e formimit profesional dhe i jep atij pervojë/vjetërsi të formalizuar në marrëdhëniet e punës duke e rritur forcën e tij konkurruese në mundësitë për punësim me kohë të plotë.
- do të rritet volumi i aktiviteteve ekstra-kurrikulare për studentët/alumni si trajnime specifike në IT, Financë, Marketing dixhital, Juridik, Gjuhë të Huaja, në fund të të cilave studentët do të pajisen edhe me certifikatë aftësie nga agjensi të specializuara ndërsa trajnimi do të kryhet falas nga TBU.
- do të shtohet oferta akademike me më shumë orare dhe kalendare alternative për studentët e angazhuar në praktika apo të punësuar me kohë të pjesshme apo të plotë për të eliminuar çdo pengesë të përfshirjes në praktikë a punë të studentëve krahas mësimit në shkollë.

\*\*\*

Nga procesi i hartimit të strategjisë u arrit në konkluzionin se ka ardhur koha që TBU të adaptojë edhe një objektiv të dytë lidhur me karrierën profesionale të studentëve të vet - atë të përfshirjes në biznes të studentëve.

Në fakt, angazhimi i TBU për nxitjen dhe mbështetjen e përfshirjes në biznes të studentëve të vet ka nisur që në vitet e kaluara e nga ku kemi patur disa raste suksesi.

Vetë konkursi i përvitshëm me maturantët “Sipermarrësit e së Nesërme”, nga i cili konkurs vijnë një pjesë e madhe e studentëve, është, ndër të tjera një shtysë. Gjithashtu çdo vit në TBU janë organizuar disa aktivitete me temë sipërmarrjen dhe nxitjen e studentëve për sipërmarrje, nga vetë TBU ose në bashkëpunim me agjenci shqiptare apo të huaja që ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare në këtë drejtim.

Në vitin akademik 2016-17 në TBU u aplikua për herë të parë “inkubatori i biznesit” përmes së cilit dy studentëve iu ofrua për më shumë se një vit mbështetje pa pagesë për zyrë dhe shërbime zyre krahas këshillimit dhe ndërmjetësimit në hapat e para të nisjes së biznesit të tyre. Njëri prej studentëve ka ecur mjaft mirë me biznesin e tij dhe tashmë ka dalë në zyrë më vete dhe ka punësuar 2 studentë të tjerë të shkollës. Ndërsa 16 studentë të tjerë aktualisht janë në procese të ngritjes së bizneseve të reja apo në konsolidimin e një biznesi të ngritur pak kohë më parë. Në katër raste në bizneset e studentëve përkatësisht janë punësuar student të tjerë të shkollës sonë.

Bazuar në këto arritje dhe përvojë të fituar por edhe në rritjen e pritshme të potencialit financiar, teknik dhe të partnershipit të TBU, përcaktohet objektivi nr. 2 **“nga fundi i periudhës 6-vjeçare të paktën 10% e studentëve të jenë perfshirë në një veprimtari sipërmarrëse të suksesshme”**.

Për arritjen e këtij objektivi, krahas llojeve të aktiviteteve të sipërcituara të kryera deri më sot e të cilat do të shtohen e fuqizohen, TBU:

- Do të krijojë një fond të vetin financimi për start-up të studentëve dhe alumni (në tentativë brenda vitit akademik 2022-23)
- Do të bashkëpunojë më ngushtë me fondin e grupit Balfin “Jep idenë tënde” për përfshirjen e më shumë studentëve me projekte biznesi
- Do të shtojë çdo vit aktivitete ekstra-kurrikulare për të trajnuar studentët për start-up dhe për gjetjen e burimeve alternative të financimit
- Do të tentojë që fondin e vet për financimet start-up ta shtojë me bashkëfinancime nga partnerë të tjerë biznesi (nga fundi i periudhës 6-vjeçare)

\*\*\*

Nga procesi i konsultimeve, veçanërisht me studentët, rezultoi se një pjesë e studentëve me rezultate të larta synojnë vijimin e studimeve master apo të ciklit të tretë në Europë dhe Amerikë. Gjithashtu një pjesë e studentëve synojnë karrierën profesionale, kryesisht atë në administrim biznesi, jashtë Shqipërisë.

Kjo shtroi nevojën që shkalla dhe cilësia e përgatitjes së studentëve të TBU të synojë standarde të nivelit European. Natyrisht që programet dhe metodat e përdorura deri më sot në TBU janë të përditësuar por përgatitja e studentëve tanë për një konkurrencë më globale kërkon një përqëndrim më strategjik në këtë drejtim për periudhën e ardhshme 6-vjeçare.

Nga këtu del edhe objektivi nr. 3 strategjik, ai i **“përmirësimit dhe përditësimit të vijueshëm të programeve e metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies në standarde Europiane për përgatitje të studentëve tanë për një konkurrencë globale”**

Për arritjen e këtij objektivi TBU:



- Do të vijojë me zbatimin e rekomandimeve të marra nga eksperti holandez (marrë në vitin akademik 2016-17) për shtimin e lëndëve me natyrë menaxheriale në programin bachelor dhe master dhe përdorimin më të shumtë të punës në grup dhe projekteve të studentëve kundrejt mësimit klasik leksione/seminare.
- Do të hapë një profil të ri në fakultetin Administrim Biznesi me emertimin “Menaxhimi i teknologjisë” (në tentativë për vitin akademik 2019-20) që do t’i pergatisë administratorët e biznesit me njohuri mbi teknologjinë dhe menaxhimin e saj. Ngritja e një fakulteti të tretë siç përcaktohej në strategjinë e mëparshme konsiderohet e padobishme.
- Do të zbatohet sistemi i studimeve të integruara 5-vjeçare në Drejtësi duke ruajtur profilin “E Drejtë Biznesi” gjithashtu do të mbështeten me programe ekstra studentët e TBU dhe alumni që do të konkurojnë për në shkollën e Magjistraturës, atë të Avokatisë, Noterisë, apo qëata të mund të marrin licencën e Përmbaruesit, Ndërmjetësit, Arbitrit.
- Vlerësohet se programi master profesional në Administrim Publik nuk shfaq dobi për vijimësi ndaj nuk do të kerkohet riakreditimi i tij.
- Do të shtojë programet e shkëmbimit (student dhe pedagogë) me fonde Erasmus dhe fonde të tjera me shkolla të larta jashtë vendit, më së shumti në Europë por, pa përjashtuar mundësinë edhe për në ShBA, Kanada, Japoni, Kine etj. Për këtë qëllim janë vendosur kontaktet e para me një numër shkollash të larta.
- Do të tentohet hapja e një programi master, në tentativë brenda vitit akademik 2022-23, në bashkëpunim me një shkollë të lartë europiane (në këto momente po shihen tre mundësi të këtitilla me shkolla britanike, austriake dhe gjermane).
- Do të vendoset në kushtet e kontratës kritere më të matshme për stafin akademik lidhur me përditësimin cilësor të programit lëndor dhe metodologjisë së mësimdhënies si dhe të ecurisë individuale në kerkimin shkencor dhe fitimin e titujve e gradave shkencore.
- Do të përditësohen çdo vit kurrikulat lëndore të programeve duke konsideruar modifikime metodologjike dhe literaturë të lëndëve të caktuara apo futje e lëndëve të reja.
- Do të përmirësohen kriteret e përfimit të zbritjeve tarifore nga studentët për shkak të rezultateve duke kërkuar më shumë përfshirje të studentëve cilësorë, në veçanti ata në master i shkencave, në kerkim shkencor aplikativ si edhe në mesimdhënie me qëllim parapërgatitjen e studentëve/alumni tanë më të mirë të master i shkencave si pedagogë të ardhshëm në TBU e jo vetëm.

- Nga fundi i periudhës 6-vjeçare synohet që TBU të jetë gati për të aplikuar në një agjensi ndërkombëtare për akreditim institucional dhe/ose të programeve krahas akreditimit shqiptar.

\*\*\*

Mbas tetë vitesh të veprimtarisë, është mëse e natyrshme që edhe në drejtim të kërkimit shkencor TBU të ketë synime më të spikatura, por gjithnjë duke mbetur realiste për dimensionin e vet dhe mjedisin që e rrethon.

Kërkimi shkencor krahas synimit për një vetëzhvillim të kapaciteteve njerëzore të stafit akademik dhe përgatitjes së studentëve (veçanërisht ata të master i shkencave) me metodologjitë kërkimore, siç edhe ka qenë në periudhën e mëparshme, synon **“të zhvillohet edhe në drejtim të kërkimit shkencor institucional”** pra të jetë TBU si entitet që të përfshihet në projekte kërkimore përmes aplikimit në fonde shqiptare dhe ndërkombëtare. Më shumë e më qartë lidhur me objektivin nr.4 të strategjisë së zhvillimit do të flitet në strategjinë e dedikuar për kërkimin shkencor.

\*\*\*

TBU dallohet për një raport harmonik mes tre aktorëve themelorë të brendshëm – aksionerët/themeluesit; stafi akademik/ administrativ dhe studentët/alumni. Në veçanti studentët janë në qendër të vëmendjes dhe e gjithë axhenda e shkollës zhvillohet në shërbim të tyre. TBU dallohet për krijimin e një mjedisi të ngrohtë, njerëzor në komunikim, nxitës dhe mbështetës në zhvillim, solidar në bashkëveprim dhe të ekuilibruar në menaxhim mes tre aktorëve.

Këto tipare duhet e do të perforcohen më tej e do të konsolidohen edhe përmes përmirësimeve të raporteve e rregullave institucionale. Krahas vijimit të metodave dhe stilit të derisotëm do të konsiderohen edhe disa drejtime të reja të tilla si:

- Përfaqësim më i mirë i studentëve dhe alumni në strukturat akademike e administrative dhe në vendimmarrjen akademike dhe administrative dhe një rol më i madh i këshillave studentore/alumni në qeverisjen e shkollës (në funksion të vitit akademik 2019-20).
- Rinovimi gradual më afatgjatë i stafit akademik edhe me studentë/alumni të shkëlqyer të TBU duke i përfshirë ata në mësimdhënie dhe kërkim shkencor që në fazën e studimeve bachelor e master (përgjatë gjithë periudhës 6- vjeçare)
- Konsiderimi i përfshirjes së studentëve/alumni si dhe stafit akademik e administrativ si aksionerë në TBU (në fund të periudhës 6-vjeçare).
- Në veçanti, alumni do të nxitën e mbështeten të vetë organizohen e të kontribuojnë në zhvillimin e TBU sepse në vitet e ardhshme ata do të përbëjnë një grup numerik që do të tejkalojë edhe numrin e studentëve korrentë, duke qenë kështu një potencial i madh mbështetës për TBU.

#### **4. Buxheti në funksion të strategjisë së zhvillimit**

Buxheti në dispozicion të TBU për 8 vitet e para akademike 2010-2018 ka arritur shifrën prej afro 280 milion lekë nga të cilat mbi 120 milion janë financim nga aksionerët dhe pjesa tjetër nga të ardhurat nga studentët dhe të ardhura të tjera dytësore. Të ardhurat nga studentët janë rritur me ritëm të lartë në 4 vitet e fundit ndërsa ka ardhur në ulje financimi vjetor nga aksionerët duke arritur në vitin 2017-18 mbulimin e shpenzimeve nga të ardhurat.

Për periudhën e re 6-vjeçare të strategjisë së zhvillimit për vitet akademike 2018-24 parashikohet me mjaft realizëm që buxheti në total, pa llogaritur të ardhura nga projekte dhe aktivitete dytësore të arrijë shifrën e afro 420 milion lekë me një rritje me afro 50% krahasuar me periudhën 8-vjeçare.

Sipas kontratave të lidhura, të ardhurat e pritshme nga tarifat e studimit për vitin akademik 2018-19 sigurojnë një buxhet për paga dhe shpenzime operative prej 62 milion lekësi dhe 4 milion të tjera investime kundrejt 53 milion lekë gjithsej për vitin akademik 2017-18 dhe 2 milion lekëinvestime dhe kundrejt 46 milion lekëpër vitin akademik 2016-17 dhe 2 milion lekëinvestime. Përveçse mbulojnë shpenzimet dhe investimet, të ardhurat 2018-19 sigurojnë edhe një surplus financiar që do të përdoret për zhvillim të mëtejshëm.

Sipas parashikimeve të planit buxhetor 3-vjeçar, buxheti gjithsej në dispozicion të TBU vetëm nga të ardhurat nga studentët për vitin akademik 2019-20 parashikohet të jetë rreth 67 milion lekë dhe për vitin 2020-21 rreth 70 milion lekë. Këtij buxheti do t'i shtohen fonde për investime zhvillimi sipas nevojës me rreth 4 milion lekëçdo vit. Këtyre fondeve me gjasa do t'u shtohen edhe fonde të tjera që mund të fitohen përmes aplikimeve në projekte Erasums, fonde kërkimore, donacione, sponsorizime etj.

Përtej vitit akademik 2020-21 deri në fund të periudhës 6-vjeçare, besojmë se do të kemi një rritje mesatare prej 5% të buxhetit të zakonshëm vjetor nga të ardhurat primare të TBU e këtyre do u shtohen fonde në rritje nga burime të tjera.

Në konkluzion, Strategjia e Zhvillimit për periudhën 2018-24 është e mirëmbështetur edhe me fonde nga burime primare dhe sekondare të TBU, e ku të parat do të kenë një rritje konstante me 5-10% çdo vit ndërsa të dytat një rritje sipas suksesit të projekteve në gjetje fondesh.

#### **5. Detyra për strukturat akademike dhe administrative**

Bazuar në këtë strategji, strukturat akademike (senati, dekanatet dhe departementet, komisionet dhe njësitë e tjera) si dhe strukturat administrative (Bordi Administrativ, Administratorët, zyrat mbështetëse) do të zhvillojnë planin e tyre specifik të punës që do të ndërmerret për zbatimin me efektivitet dhe efijencë të strategjisë dhe arritjen e objektivave të saj vit pas viti.

Çdo njësi organizative statutore, krahas ndjekjes në vijimësi të detyrave të percaktuara për vitin akademik 2018-19, e që është viti i parë i zbatimit të strategjisë, do të përgatisë planin e punës,

për pjesën respektive të detyrave që i'u takon për vitin akademik 2019-20. Drafti i parë i çdo plani duhet të jetë perfunduar brënda Qershorit 2019 e duhet t'i përcillet organit me të lartë apo epror sipas rastit.

Plani i punës së departamenteve që lidhet me çështjet akademike koordinohet nga dekanatet përkatëse e në rang shkolle nga zev. Rektori. Për çështjet administrative plani i punës zhvillohet nga administratorët e fakulteteve në bashkëveprim me administratorin e shkollës dhe Bordin e Administrimit.

Në tentativë, plani i punës për vitin akademik 2019-20 do të duhet të paraqitet në Bordin e Administrimit dhe/ose në Senatin Akademik brenda muajit Korrik 2019.